

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 13-19.01.2025

Janë testuar gjithsej 282 materiale në Laboratorët ku bëhen analiza molekulare për vërtetimin e pranisë së virusit SARS-CoV-2. Krahasuar me javën që shkoi (n=259) është shënuar një rritje prej 8,9%.

Janë regjistruar 2 raste pozitive, 4 më pak se javën që shkoi, përqindja e rasteve pozitive sillet nga 0,0% deri më 2,6%, mesatarisht 7,0%.

Tabela 1. Numri i testimeve dhe rasteve pozitive në periudhën nga 13-19.01.2025

Data	Testime	Pozitive	% e rasteve pozitive
13.1.2025	47	1	2,1%
14.1.2025	38	1	2,6%
15.1.2025	73	0	0,0%
16.1.2025	39	0	0,0%
17.1.2025	42	0	0,0%
18.1.2025	17	0	0,0%
19.1.2025	26	0	0,0%
Gjithsej	282	2	Mesatarisht 0.7%

Gjatë javës së kaluar të sëmurë janë regjistruar në Kratovë dhe në Shkup.

Gjatë javës së kaluar (13-19.01.2025) janë regjistruar si të shëruar 5 persona, ndërkohë që nuk është raportuar rast i vdekjes si pasojë e COVID-19.

GJENDJA ME COVID-19 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË VITIN 2025

Gjatë vitit 2025, deri më 19.01.2025, janë regjistruar gjithsej 13 raste me COVID-19. Në muajin dhjetor të vitit 2024 (6) regjistrohet një rënie prej 50% për dallim nga një muaj më parë.

Gjatë vitit 2025, deri më 19.01.2025, janë testuar gjithsej 707 materiale, në laboratorët në të cilët realizohen testime molekulare për prani të SARS-CoV-2 dhe në laboratorët / institucionet shëndetësore në të cilat bëhen testimet e shpejta antigjene.

Vlerësimi i rrezikut

Shkalla e ulët e transmetimit të SARS-CoV-2, rënia e numrit të raportimeve dhe testimeve ndikon në aftësinë për vlerësimin e gjendjes epidemiologjike. Popullata e EU/EEA në përgjithësi ka një nivel të konsiderueshëm të imunitetit hibrid (vaksinim/vaksinim me booster doza), që ofron një mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes.

Personat mbi 60 vjet janë më të rrezikuar nga pasqyra e rëndë e sëmundjes.

Hospitalizimi i personave me COVID-19 të konfirmuar, pranimet në kujdesin intensiv dhe vdekjet mbeten në nivel të ulët në vendet e BE-së. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme në R. e Maqedonisë së Veriut.

Edhe pse numri i të sëmurëve me COVID-19 në javë po shënon rënie, duke pasur parasysh se fillon periudha e qarkullimit të shtuar të viruseve respiratore në hemisferën veriore, ekziston rreziku që aktiviteti i SARS-CoV-2 të rritet, gjë që e thekson nevojën e vazhdueshme për mbikëqyrje (epidemiologjike dhe virologjike) në nivel kombëtar dhe rajonal.

Masa të rekomanduara për parandalim dhe kontroll

Rekomandohet ndjekja e masave themelore për parandalimin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera respiratore.

Vaksinimi mbetet si masë specifike që mundëson mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes, edhe pse ky efekt mbrojtës me kalimin e kohës dobësohet. Mbetet rekomandimi për vaksinimin e personave me rrezik të lartë nga format e rënda të sëmundjes (siç janë personat më të moshuar).¹

Shkup, 20.01.2025

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse

Instituti i Shëndetit Publik

¹ <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0039%20Final.pdf>